



02Nr. 1719/2023
01.03.2023

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Komuna Hani i Elezit shpallë:

KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

1. Titulli I vendit të punës: **Edukatorë Mbështetës/e
njësia/ sektori: SHFMU "Ilaz Thaçi"**

Numri I pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**

Koeficienti/Grada: **E-20-5.2**

Orët e punës: **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës :

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimor dhe edukativ,
- Përdor metoda dhe teknika bashkohore të mësimdhënies duke marrë parasyshë
- Nevojat individuale të nxënësve;
- Harton plane individuale për nxënësit;
- Të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme të aftë, që të krijoj mardhënie me të tjerët;
- Mësimin e rregullave dhe bashkëpunimin në grup;
- Duhet të jenë të motivuara që të punojnë me fëmijë;
- Kryen punë tjera që I cakton drejtori i institucionit;

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

- Fakulteti i Edukimit-programi parashkollor;
- Fakulteti i Edukimit-programi pedagogji;

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jene kopje të noterizuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 31.03.2023 deri 14.04.2023 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati I parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net> Dokumentacioni I kandidatëve të cilët nuk I plotësojnë kriterete konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që I plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniiielezit> dhe në tabelën e shpalljes.



**Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi**